



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

D E K R E T
PER
KTHIMIN E LIGJIT NR. 8813, DATE 17.05.2001,“ PER DISA
SHTESA E NDRYSHIME NE LIGJIN NR. 7905, DATE 21.03.1995
“ KODI I PROCEDURES PENALE I REPUBLIKES SE SHQIPERISE ”

Në mbështetje të neneve 85 dhe 93 të Kushtetutës

D E K R E T O J:

Kthimin për rishqyrtim edhe njëherë në Kuvend të ligjit nr 8813, datë 17.05.2001 “ Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë “”

Tiranë, më 18.06.2001
Nr i dekretit 3063

PRESIDENTI I REPUBLIKES
REXHEP MEIDANI



8

MOTIVIMI I KTHIMIT TE LIGJIT NR 8813, DATE 17.05.2001 “ PER DISA SHTESA E NDRYSHIME NE LIGJIN NR. 7905, DATE 21.03.1995 “ KODI I PROCEDURES PENALE I REPUBLIKES SE SHQIPERISE “

Të nderuar deputetë !

Duke patur parasysh sygjyerimet e dërguara nga Konferenca Kombëtare Gjyqsore, dhe pas disa konsultimeve të zhvilluara, ligjin nr. 8813, datë 17.05.2001, vendosa të mos e shpall, por ta kthej edhe një herë për shqyrtim në Kuvend, me qëllim përmirësimin e tij. Kjo për faktin se në të konstatohen formulime që vijnë ndesh me legjislacionin në fuqi, e konkretisht:

I. Në ligj është parashikuar suprimimi i Gjykatave Ushtarake të shkallës së parë dhe të Apelit. Unë mendoj se një gjë e tillë duhet të rregullohet nëpërmjet ligjit organik “ Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqsor ”. Në nenet 6, 9 dhe 10 të ligjit në fjalë, nr. 8439, datë 28.12.1998, i ndryshuar me ligjin nr 8656, datë 31.07.2000, këto gjykata aktualisht janë në përbërje të sistemit gjyqsor shqiptar. Në rastin eventual të heqjes së kompetencës lëndore këtyre gjykatave sipas ligjit procedural penal, atëhere detyrimisht që një gjë e tillë duhet të shoqërohet edhe me suprimimin e tyre me ndryshimet përkatëse në ligjin organik. Nëse ky ligj do të dekretohet nga ana ime, do të krijohet situata që gjykatat ushtarake të mbesin, ndërkohë që ato nuk do të gjykojnë për mungesë lënde për gjykim. Ligji procedural nuk është ligj që krijon apo shpërbën gjykata, por ai përcakton kompetencat e tyre.

Veç sa më sipër, nëse duhen suprimuar këto gjykata ose jo, unë mendoj se është një çështje studimi dhe kërkon një analizë të plotë dhe të konsultuar me të gjithë aktorët, në zbatim të ligjit “ Për organizimin e pushtetit gjyqsor në Republikën e Shqipërisë ”, nenet 11 dhe 12 të tij.

II. Në nenin 147, pika 1, të Kushtetutës është parashikuar juridiksioni fillestar i Gjykatës së Lartë. Ndërkohë, në nenin 75/a të ligjit, është tentuar të zërthehet kjo dispozitë kushtetuese, por konstatoj se nuk i është shkuar deri në fund, duke krijuar në këtë mënyrë konfuzion në zbatimin e saj, vecanërisht për dy momente të rëndësishme:

9

a) Gjykata e Lartë në këtë rast do të gjykojë me një koleg të përbërë nga 5 gjyqtarë, apo me përbërjen e të gjithë trupës gjyqsore. Parë në raport me Kushtetutën dhe nenin 3 të ligjit, mund të kuptohet se në rastin e juridiksionit fillestar, Gjykata e Lartë gjykon me një përbërje prej 5 gjyqtarësh. Megjithatë, një gjë e tillë duhet thënë në mënyrë të shprehur e jo të nënkuptohet.

b) Ligji duhej të rregullonte edhe çështjen nëse vendimi i kolegjit është një vendim përfundimtar dhe i paankimueshëm apo mund të ankohet në Kolegje të Bashkuara. Cilado qoftë zgjidhja, në ligj duhet të parashikohet.

Bashkëlidhur ju dërgoj edhe disa mendime të Konferencës Kombëtare Gjyqsore për këtë ligj.

Duke shpresuar në mirëkuptimin Tuaj,

**PRESIDENTI I REPUBLIKES
REXHEP MEIDANI**

